



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008 dhe 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01. nr. 013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 4 të Rregullores për ndarjen e ndihmave momentale në të holla nr. 01-013/860 të datës 17.07.2012, Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë shqyrtoi kërkesën e SHF të Dëshmorëve të Komunës së Vitisë dhe bien këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ **500,00€** SHOQATËS SË FAMILJEVE TË DËSHMORËVE TË KOMUNËS SË VITISË

Neni 1

Kryetari i Komunës së Vitisë NDAN mjete financiare në shumë prej **500,00€** (pesëqind euro), Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Komunës së Vitisë në emër të mbështetjes financiare për kryerjen e aktiviteteve të Shoqatës të Familjeve të Dëshmorëve të Komunës së Vitisë.

Neni 2.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga kodi për subvencione i Zyrës së Kryetarit dhe derdhen në llogari të Kryetarit të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë.

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti



Vendimi u dorëzohet:

1. Kryetarit të Shoqatës
2. Zyrës së Kryetarit
3. Zyra e Thesarit
4. Arkivit